

## NYSRET KRASNIQI

### METAFIZIKA POETIKE REFLEKSIONE PËR POEZINË E SABRI HAMITIT

#### I. Parantezë

Metafizika, gruaja me tipare të zanave tona mitologjike<sup>1</sup>, që e shihte dhe kishte aftësi të fliste me syrin e Providencës, që siguron mbrojtje e kujdes për ne, u bë simbol i ndërlidhjes së njeriut, qenies, ekzistencës sonë në këtë botë, me vullnetin e Saj, e cila mbikëqyr sjelljen dhe moralitetin e krijesës së vet, sjellje e moralitet që shfaqet në trajta e forma të ndërlikuara të mendimit dhe të veprimit.

Në këtë ndërlidhje, Metafizika u bë ura dhe udha e përhershme ndërmjet Qenies e Providencës.

Meqë jemi te mitologjia, nëse Hermes, rrjedhimisht hermeneutika, sjell alegorinë e Providencës, me të cilën Qenia jeton dhe përpiket të zbulojë e rizbulojë vullnetin e Providencës, Metafizika sheh e dërgon, madje ia mundëson Qenies formën e ndërliqshme të *imagjinimit* të Providencës si kult, pikëpyetje, përkushtim e Paskajësi.

Ky komunikim primordial i Qenies me Metafizikën nuk është shuar kurrë si dhe nuk do të shuhet kurrë, rrjedhimisht, i ndërlidhur me jetën njerëzore, jeton në vazhdimësi në *kohën zero*.

Mirëpo, jeta njerëzore dhe jeta individuale e njeriut, edhe pse të ndërlidhura si vetëdije, dallojnë për faktin se, e para, priret drejt infinitit, (nëse këtu e harrojmë konceptin për apokalipsin të feve abrahamike), ndërsa, e dyta, drejt finitit të vetëdijshëm.

Filozofët thonë se, nga të gjitha qeniet, vetëm njeriu është i vetëdijshëm për fundin e vet! Sidoqoftë, koha kalimtare e jetës së njeriut arrin t'i japë trajtat e format e veta, shenja të cilat, kur arrijnë në artikulime të veçanta e me

---

<sup>1</sup> Jemi të vetëdijshëm për problematikën etimologjike që sjell nocioni *metafizikë*, qoftë e parë nga gjuha e vjetër greke si *meta* (mbas) *physis* (fizika) apo e parë nga rendi i librave të Aristotelit, ku thuhet se nocioni Metafizikë nuk është më shumë sesa rendi i shkrimeve të filozofit antik mbas veprës së tij Fizika, qoftë si konceptim filozofik të asaj që *meta-fizikë* do të thotë *diçka që shkon përtej fizikës*. Mirëpo, ne, këtu, e huazojmë konceptin për metafizikën siç është paraqitur në fontespicin e veprës *Scienza Nuova* të Giambattista Vico-s (botimi i dytë, 1725), ku Metafizika paraqitet si një grua që ka aftësi të komunikojë njëkohësisht me Providencën dhe me botën tokësore. Ky konceptim, në fushë të refleksionit për artin, i përshtatet më shumë *imagjinimit poetik*.

premissa universale, domosdo Metafizika “i sheh” dhe me vetë faktin që i sheh i pranon si *kulturë të lartë*,<sup>2</sup> rrjedhimisht i integron si traditë e jetës njerëzore që komunikon me të, e cila jeton në kohën zero.

Synimi dhe arritja e *kulturës së lartë* ka në themel besimin primordial, gjithësi religjioz, pra kultin për metafizikën si preokupim i vazhdueshëm e gjithësi edhe si udhë drejt Providencës hyjnore.

Në këtu e shohim Metafizikën si formë të të menduarit për *realitetin ultimativ* apo final, i cili ndonëse nuk ndërlihet drejtpërdrejt me Zotin është komplementar me të menduarit për të.

Metafizika jeton me gjuhën e figurshme, me gjuhën e metaforës dhe të simbolit. Metafizika flet dhe dërgon metaforë e simbol, ngase gjuha njerëzore lindi si metaforë e po ashtu Providenca shfaqet në rrëfimet dhe skriptat shejte nëpërmjet metaforës.

Metafora nuk është vetëm figura e retorikës së vjetër, e tropologjisë apo e stilistikës së re, por është fusha e ambiguitetit veprues që shpërfaq duke mbuluar dhe mbulon duke shpërfaqur, pra një palcë filozofike aktive e reaktive, e cila në udhën e kohës së matshme njerëzore e kanonizoi vetveten në mbretëreshë të gjuhës, rrjedhimisht të figurave të motivueshme që burojnë nga gjuha.

Providenca, Metafizika, Metafora, kjo shkallore shkakore banon në Qenien njerëzore si imanencë filozofike në synimin për ta kuptuar të Vërtetën apo, siç e riaktualizoi Hajdegeri termin e vjetër grek, për të jetuar në botën e *Aletheia-s*.<sup>3</sup>

Meqenëse gjuha lindi si metaforë dhe metafora u bë imanencë e kërkimit të së Vërtetës, del se qenia njerëzore, në shprehësinë e saj përkushtuese e mendimtare, në pikëpyetjet e saj konceptuale filozofike, në format e ndërliqshme të religjiozes, e latoi edhe më shumë këtë figurë-amzë, duke e identifikuar me *poiesisin* - Poezinë, rrjedhimisht duke e ndërlihur në thelb *poiesisin* - poezinë me Metafizikën, gjithësi në këtë udhë edhe me format e tjera të religjiozitetit.

Burimësia e poezisë dëshmon se në shpirtin dhe bërthamën e saj, Qenia manifeston dialogimin me metafizikën si udhë të kultit ndaj Providencës, ku metafizika bëhet teatër i zbulimit e mbulimit dhe i përhershmerisë intencionale të Qenies për ta kërkuar të Vërtetën.

Nuk ka poezi pa metaforë, nuk ka metaforë pa metafizikë, rrjedhimisht nuk ka metafizikë pa syrin omniprezent të Providencës hyjnore. Kjo trini e ka formuar dhe zotëruar që në thelb filozofinë krijimtare të stilit të lartë, si *kulturë e lartë*, të çdo Poeti, që nga Antika e deri më sot.

<sup>2</sup> Shih: Roger Scruton, *Modern Culture*, Bloomsbury, London, 2006.

<sup>3</sup> Shih: Martin Heidegger, *Poetry, Language, Thought*, Harper Perennial, New York, 2001.

Poeti i tillë, i mburjtur në këtë trini, qoftë edhe para etablimentit të nocionit të Autorit, qoftë pas formësimit të këtij nocioni, është Autor, si shëmbëlltë e kësaj trinie.

## II. Tezë

Udha e poetit, në synimin e tij që nëpërmjet metaforës e metafizikës të mbërrijë te njohja e Providencës, përshkohet nga dashuria dhe moraliteti i krijimit; dashuri për Qenien dhe Natyrën, për kultin e besimit dhe të admirimit në të bukurën estetike dhe shkronjën si mjet të rikujtesës, kujtesës dhe lënies trashëgim të këtij kultit e besimi në estetikë. Një udhë e rëndë, e cila, në esencë, i jep fuqi shpirtit në dëm të kënaqësisë së trupit.

Poezia kult, qoftë më bazë në mimetikë (si shkak-pasojë e jetës dhe natyrës ku banon njeriu), qoftë si shpërthim i meditacionit të vetëdijes e të pavetëdijes subjektive (si krijim i botës shprehëse si dhembje individuale psiko-somatike) jeton në *imagjinatë*.

Poeti imagjinon, hyn në botën e imagjinatës, e cila bëhet teatër krijimtar në të cilin qëndron në “lojë” metafizika duke ia shtuar misterin kultit të imagjinatës, për të “ndihmuar” në krijimin e vargjeve si përjetim i thellësishëm i së bukurës, si një *katharsis* permanent. *Katharsisi* permanent nuk buron nga fantazia, nga *simulakrumi*, por nga përjetimi i thellë ndjenjor i botës, i realitetit, i cili shkakton shkrirjen e poetit në vargjet e tij.

Kjo fuqi imagjinate nuk i përngjitet asnjë pretenduesi që shprehjen në metaforë, në poezi, nuk e ndjen dhe nuk e përjeton si dialogim me metafizikën, si shëmbëllim i religjiozitetit (adhurim e besim), si një ndërlidhje të *psyche*-së me *format ideale*.

Poeti, i cili e ndjen këtë peshë, shprehësinë poetike nuk e pandeh si lojë, por si sakrificë. Loja është *fantazi* e *simulakrum*, ndërsa sakrificat është dhembje e moralitet, pra një kult që ka bërthamë religjiozitetin. Kultit i religjiozitetit poetik në imagjinatën e poetit, qoftë edhe kur poeti rastis të jetë pjesëtar i ndonjë doktrine fetare, nuk ka nevojë imanente për ndonjë doktrinë specifike. *Imagjinimi poetik* është udha drejt Providencës hyjnore pa nevojën e doktrinave. Është estetika e religjiozitetit e jo idolatria religjioze. Rrjedhimisht sakrificat e poetit lidhet me estetikën si bijë e filozofisë, por poeti e synon Providencën nëpërmjet metafizikës duke zgjedhur udhën autonome.

## III. Modele

Ne, si kulturë, jemi produkt i Rilindjes. Mirëpo, kultura *filobiblike*<sup>4</sup> e *filokuranike* është pararendësja e saj. Kundruar në këtë fenomen ne mund të flasim për metafizikën e Bogdanit, e gjithashtu edhe për metafizikën e Nezimit.

---

<sup>4</sup> Shih: S. Hamiti, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003.

Gjithashtu, Rilindja, e cila te ne bashkohet me Romantizmin e tipit nacional, formoi metafizikën e Jeronim de Radës, metafizikën e Naimit e gjithsesi edhe metafizikën e Gjergj Fishtës.

Vargu poetik, te këta autorë, nuk u largua nga metafora (metaforika) që çon te metafizika, pra poezia u pa në esencën e saj, kult e religjiozitet, shpeshherë duke kapërcyer doktrinën fetare. Pra, religjioziteti i vargut të tyre poetik nuk jetoi domosdo si hije e doktrinës, por u pasurua me astrologji, misticizëm e mitologji, të cilat megjithatë janë forma të religjiozitetit apo të transcendencës.

Gjithashtu, bota folklorike, fort e pranishme në romantizëm, ngërtheu në vetvete format më të ndërliqshme të religjiozitetit.

Për më tepër, kulti i veçantisë nacionale, i gjuhës, i heroit, madje edhe i historisë u pa me religjiozitet. Rrjedhimisht, poezia ruajti kultin esencial si teatër i komunikimit të reales me metafizikën në udhën drejt Providencës hyjnore, qoftë edhe duke integruar në trupin e saj edhe kultin e Identitares nacionale. Madje, identitarja nacionale u pa dhe u nderua me masën e kultit për Providencën hyjnore. Në këtë dritë, dhe jo rastësishëm, del dhe forcohet bonimi sublimues i kësaj tradite i Gjergj Fishtës *atme e fé*, ku atdheu është identitet e feja është metafizikë, që të dyja si shëmbëlltyrë e hyjnishme.

Në këtë përvijim të religjiozitetit të poezisë apo të komunikimit të saj me metafizikën, gjithsesi duhet të përmendim Ndre Mjedjen, i cili krijoi poezinë kult, si alegori, dialogim e filozofemë me format transcendentale.

Nuk mund të flitet për romantizmin shqiptar pa vetëdijen për religjiozitetin e poezisë dhe pa kuptimin e esencës së lidhjes së hallkave të këtij religjioziteti me traditën e shkrimit mesjetar e pararomantik, madje edhe pa mitin e iluzionin historik, pa arkeologjinë e historinë etnike. Vargu i simboleve që nga lashtësia deri në romantizëm është varg i simboleve të mbujtura me religjiozitet, rrjedhimisht si kult i komunikimit metafizik, pa të cilat nuk do të mund të krijohej asnjë bërthamë identitare.

Miti e simboli pellazgjik, kulti i perëndive e shenjave ilire, kulti i gjuhës si veçanti, kulti i heroit mesjetar, Rilindja si rizbulim e sforcim madje si rikrijim, janë vetëm disa nga simbolikat nëpërmjet të cilave autorët nacionalë ikën nga fizikja (nënkuptojmë këtu kërkesën metafizike të poezisë) në drejtim të imagjinares nëpërmjet simboleve.

Simbolet gjithsesi janë imagjinime ambiguale transcendentale, qoftë edhe kur ndërlidhen me situata reale, që i tejkalojnë doktrinën fetare, të cilat shpeshherë dinë të marrin elemente ideologjike, për të jetuar në një botë të veçantë të hapësirës së transcendencës.

Në vijën evolutive të letërsisë shqipe, modernizmi vetëm sa e ngriti edhe në një stad më të lartë konceptin për imagjinaren poetike, madje duke e parë poezinë edhe më qartë si kult e religjiozitet, si të vetëmjaftueshme dhe autorin si udhëtar të përhershëm drejt Providencës së imagjinuar hyjnore. Shembull

tipik i kësaj filozofie është Lasgush Poradeci, i cili e pëlqeu metafizikën e Naimit, por krijoi imagjinaren e tij metafizike në çdo metaforë të poezisë së tij. Metafizika e Lasgush Poradecit u bë ura e komunikimit të tij poetik me Providencën hyjnore duke i relativizuar doktrinat fetare, por duke e forcuar jashtëzakonisht stilin e lartë të shprehësisë poetike, duke e ngritur në kulm *kulturën e lartë* në poezinë shqipe. Metafora, Metafizika dhe Idealja janë konceptet qendrore që e mbajnë kultin e poezisë së tij, por e kthejnë autorin empirik në njërin nga krijuesit më të pakuptuar, madje të ndëshkuar me harresë si formë të vdekjes për të gjallë të tij.

Në këtë rend i përmendëm vetëm disa autorë të traditës poetike shqipe, me fokusin në metafizikën e poezisë së tyre. Rrjedhimisht këta janë edhe autorët themelorë të *kanonit poetik metafizik*.

Ne nuk themi se këtu nuk ka diferencë apo edhe forma të ndërliqshme e komunikim jometafizik në poezinë së tyre. Mirëpo, ne fokusuam *dominantën* apo konceptin filozofik për poezinë, rrjedhimisht metaforën dhe metafizikën.

#### IV. Kanoni

Tashmë, poezia shqipe e ka *kanonin*<sup>5</sup> e saj, i cili përbehet nga *autorët* e poezisë shqipe, të cilët i bashkon *diferenca* e jo *repeticioni*. Në *kanon* nëpërmjet *diferencës* rri tradita poetike shqipe si testament për ne në *përhershmërinë* e poezisë nacionale. Një poet, i cili nuk e njeh këtë *testament* jeton me supozimin se ai nuk ekziston dhe vargu i tij do të mbetet shprehje e tipit *sui generis*. Mirëpo, vargu *sui generis* nuk është *kulturë e lartë*, është kompromis e jostabilitet, sentimentalizëm i tepruar, rrjedhimisht i destinuar ose në lojë ose në ideologji.

Në këtë përsiatje të mendojmë për tendencën e përjashtimit të kanonit si dhe të mohimit të autorit që të meditojë e imagjinojë metaforë, metafizikë e providencë në kohën e ideologjisë marksiste kur religjioziteti u pa në teknologji e shpirti njerëzor u la në duar të Djallit.

Për këtë arbitraritet në kulturën shqipe nuk do të flasim këtu, por do të bëjmë vetëm një pyetje që në fakt është pikëpyetje: Cili poet i ikjes nga metafizika i kësaj periudhe më se gjysmëshekullore mund të mendohet si shenjë plus në kanonin poetik të letërsisë shqipe?!

#### V. Refleksione

Sabri Hamiti është njohës i filozofisë së artit, do të thotë i parimit universal se arti është *estetikë*, një ngulmim në të bukurën artistike. Estetika në poezi realizohet nëpërmjet *fuqisë së figurave, metaforikës*, e cila ngulmon në

---

<sup>5</sup> Për konceptin teorik-filozofik të *kanonit* shih: Harold Bloom, *The Western Canon*, Harcourt Brace, New York, 1994.

komunikim me *metafizikën*. Kjo vetëdije estetike e dominon poezinë e Sabri Hamitit që nga fillimi e deri më sot.

Në poezinë e këtij autori nuk ka ideologji, retorikë e pompozitet, lamentim e sentimentalizëm, por ka vetënjohje, njohje e universalitet të dhembjes së përhershme që përjeton autori që kur hyn në botën e mistershme të artit letrar.

Poezia e këtij autori është *sistem i imagjinatës*.

Dashuria për vargun metaforik në poezi, në fakt, është dhembja e autorit për qenien njerëzore, qenien nacionale, jetën e vdekjen, pra një botë e poezisë ku dominon misteri i jetës dhe i vdekjes, i njohjes dhe vetënjohjes në trajtat më të fuqishme të saj. Rrjedhimisht, poezia e Sabri Hamitit është poezi e nivelit të lartë, elitë në poezinë tonë, pra *kulturë e lartë*. Gjithashtu, kërkon njohje të thellë estetike e filozofike për të hyrë në sistematikën e figurës së saj.

Këtu, në formë sinopsisi, do të paraqesim një “udhëtim” fenomenologjik me poezinë e autorit, duke u përpjekur të hetojmë *dominantën* e poezisë së tij, shikuar gjithnjë nga prizmi i komunikimit metafizik si fushë e meditacionit imanent.<sup>6</sup>

Poeti nisët i ri dhe, kundruar fenomenologjikisht, poezia nis në rini, ndërsa përjashtimet janë të rralla.

Vepra që e nis udhën poetike të Sabri Hamitit është *Njeriu vdes i ri* (1972).

Ky titull kontemplativ, i pazakontë në poezinë shqipe, thërret në *botën imagjinare*, pra metafizike. Imagjinaria për vdekjen e *njeriut në rini* është fusha e meditacionit filozofik e artistik: *njeriu është i gatshëm të vdesë që kur lind, njeriu lind i vdekur, njeriu vdes duke jetuar*, – pra, një titull i krijuar që rikrijon polivalencë semantike.

Për më tepër, nëse titulli ndërlidhet me subjektin lirik sugjeron *vdekjen në vargjet e krijuara si meditacion metafizik*, si kredhje në sakrificën e krijimit, si vdekje në fatkeqësinë e bukur të artit, një *udhëtim* i përbashkuar me *ëndërrim* metafizik dhe *revoltë* krijimtare, si kërkim i personalitetit e individualitetit krijues, me vetëdijen për traditën.

Shtylla e traditës këtu nuk nënkupton ndërlidhjen narrative, metonimike, diskursin folklorik, apo te themi me *poezinë naive*, por lidhja është simbolike, madje transcendentale. Një frymë lasgushiane e *plakut te liqerit*, i cili shkruan për dashurinë dhe kosmogoninë, që të dyja si komunikim e në lidhje me metafizikën, reflektojnë te poeti i ri, i cili që në nisje e refuzon klisenë e kohës së tij, fantazinë e utopinë, sepse e di se lidhja e poezinë me realen duhet të jetë utilitare e kurrsesi ideologjike. Poeti i ri thotë:

<sup>6</sup> Veprën letrare të Sabri Hamitit kam bërë përpjekje ta lexoj dhe ta interpretoj në vijimësi. Si rezultat i këtij leximi e interpretimi, vepra e këtij Autori është trajtuar në nivel monografik në studimet *Sabri Hamiti* (2011) dhe *Letërsia e Kosovës 1953-2000* (2016).

*jam në rrugën mijëvjeçare  
jam i vetëm  
jam me ta*<sup>7</sup>

Vetëdija se kujtesa nuk është vetëm segmenti i jetës personale, madje segmenti i një *milieu*, por jeta personale është shumë e shkurtër në krahasim me zërat që jehojnë nga vdekja, e bën poetin “plak” në rini, të vdekur në rini!

Mirëpo, poeti është *i vetëm*, i vetmuar dhe bart fatkeqësinë e fatit që të jetë *me ta* dhe ta përjetojë krizën e fuqishme të influencës, të *agonit* si dhe, në të njëjtën udhë, të mendojë për unin e tij poetik.

Kërkimi i Unit poetik, kur uni përplaset estetikisht me traditën, pra me vargun e shenjave që bëhen trashëgimi, në fakt, është *fenomen i narçizit*, i trajtave të shfaqjes së njohjes dhe vetënjohjes me burimësi të brendshme në shprehësinë poetike. *Fenomeni i narçizit*, apo filozofema *unë jam unë* është domosdo e krenarisë poetike, “e pasqyrimit” të vetvetes në vargun poetik, qoftë edhe me vetëdijen e vdekjes, si reminishencë e Narçizit Antik. A nuk e theksoi problemin e Narçizit edhe Ernest Koliqi në *poemthat e tij në prozë*?

Narçizi, në këtë rast, është simboli i reflektimit të vetvetes. Ky reflektim identifikues nuk kërkohet në natyrë, siç na thotë miti antik, por në përbrendësi, e cila bëhet burim i qenies, i dimensionit metafizik të qenies që shkruhet në vargjet e librit poetik *Faqe e fund* (1973).

*faqja ime s'është faqe natyre  
burim e blerim i mbaj në gj*<sup>8</sup>

*Faqja* është identifikim, në kuptimin e parë i jashtëm, por e ngërthyer në metafizikën poetike faqja është identifikim i brendshëm, i reflektimit të qenies dhe kjo është synimi i kulmimit të modernitetit si shmangie nga mimetika e afria me konceptin e krijimit të botës së veçantë artistike. Kur mungon *mimetika*, rrjedha e ujit e bukura e natyrës marramendëse objektivohen *në gj*, në përbrendësi, e ku tjetër përveçse në libër, *në dialogim imagjinues me të vdekurit*.

Dialogimi imagjinues forcohet më tej në veprën poetike *Thikë harrimi* (1975), ku poeti shkruan *poezinë e imagjinatës* kryesisht si *rikujtesë e fëmijërisë*.

Realja bëhet e largët dhe imagjinimi mbi të bëhet vetëm me figurë, e cila si i kje kapërcen në metafizikë. Dominon *metafizika e vdekjes*, sepse çuditërisht, të gjallët dhe të vdekurit “vdesin” në poezinë e Sabri Hamitit! Një libër, i cili

<sup>7</sup> S. Hamiti, *Njeriu vdes i ri*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 55.

<sup>8</sup> S. Hamiti, *Faqe e fund*, Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 11.

përbashkon *poiesis*-in dhe *techne*-n e lartë, ku *format e vdekjes* (Ibrahim Rugova)<sup>9</sup> shkaktojnë *thikën e harrimit*.

*Thika*, simbol i aktit të vrasjes, e cila e “vret” poetin në qenien e tij si metafizikë e dhembjes dhe e shkakton *harrimin* apo vdekjen është *koha*. Pra, ky fenomen ireversibil që qëndron ndërmjet *kujtimit* dhe *harrimit*. Vargjet imagjinuese të poetit, të cituara më poshtë, të krijuara mbi *filozofinë e të kundërtave*, shenjojnë domosdonë e distancës me vendlindjen, ku kthimi bëhet i pamundur ngase jeta është kërkim, por mbetet vetëm *kujtimi*, i cili e lufton *harrimin* për aq sa është e mundur që kujtimi ta luftojë *kohën* rrjedhimisht *thikën*.

Vargjet e stilit të lartë krijojnë pikëpyetje. Me këtë rast bëjmë një pyetje: I nënshtrohem ne të gjithë *kohës së harrimit* apo sa është e mundur *rezistenca e fjalës* nga *thika e harrimit*?

Fjala, qoftë e mbajtur mend, qoftë e shkruar ka për burimësi një *kujtesë*, madje gjithnjë është rikujtesë e zërave të vdekur!

*ditët netët gazin i mban gjallë kujtimi  
në një kohë të moçme kisha tambel n'gjak  
koha me teh thike pret fjalë e harrimi  
kthimit miturak në rrugë i vë një lak*<sup>10</sup>

Kur poeti në *rrugë i vë një lak kthimit miturak*<sup>11</sup> dhe tashmë nuk ka *tambël n'gjak*, pra kur *thika e kohës* e çon te *pjekuria*, poeti nuk e ndalë kërkimin imagjinitiv, por e thëllon më tej luftën e tij ndaj *thikës* – kohës, pikërisht duke e pasur vetëdijen për fuqinë e kësaj thike në prerjen e kujtimit e rikujtimit që është *arki-historia*.

*Trungu dhe Koha* janë dy “opozicionet” filozofike të poetizuara në librin poetik *Trungu ilir* (1979) të poetit.

Me këtë rast, duhet të theksojmë se Sabri Hamiti poezinë e shkruan në *sistem*, pra në një lakore evolutive të vargut imagjinitiv. Mirëpo, në kuadër të kësaj lakoreje nuk kemi poezi të njëtrajtshme e refleksione të përsëritura. Libri vijues poetik e “harron” librin poetik paraprak në të mirë të zgjerimit të fushës imagjinare.

Në këtë proces të zgjerimit të fushës imagjinare *Trungu ilir* është libri për njohjen e vetënjohjen identitare. Është *Trungu*, gjeneza, rrënjët, që është Ilir në kuptimin e prejardhjes, i cili në vijimësinë historike, përplasat më thikën e *Kohës*. Ky libër poetik është *metafizikë e kulturës identitare* ku poeti imagjionon mbi dy tipet e fenomenit kulturor.

<sup>9</sup> Shih: I. Rugova, *Strategjia e kuptimit*, Rilindja, Prishtinë, 1980 dhe Ibrahim Rugova, *Refuzimi estetik*, Rilindja, Prishtinë, 1987.

<sup>10</sup> S. Hamiti, *Thikë harrimi*, Rilindja, Prishtinë, 1975, f. 102, *Poezia Vdekja e këngës*.

<sup>11</sup> *Po aty*, strofa e fundit e poezisë së cituar *Vdekja e këngës*.

Ne e dimë se ekzistojnë dy koncepte themelore për kulturën: i pari, kulturën e sheh si memorie, pra traditë, ndërsa i dyti e sheh si qytetërim modern. Imagjinimi poetik, në këtë rast, kap traditën e modernen për t'u relativizuar koha. Në këtë libër nuk ekziston fenomeni i *inventimit të traditës* (Hobsbaum)<sup>12</sup> sepse ajo ekziston dhe është dëshmi, por bëhet imanencë nevoja e poetit për të imagjinuar e reflektuar mbi traditën qenësore, e cila i flet modernes, me intencën që, thënë me figurë, kjo e fundit, me thikën apo thikat e saj ideologjike, të mos lejojë prerjen e trungut.

Kjo filozofi përforcohet edhe më shumë për faktin se identiteti nacional, i cili përbëhet nga *gjuha specifike, ndjeshmëria dhe simbolet* (Smith)<sup>13</sup> i ofron poetit të imagjinojë fuqishëm mbi hapësirën historike, mitet e përbashkëta dhe memorien historike. Fuqia e identitetit kulturor si përkatësi individuale bën që qenia të përbrendësojë sigurinë që i krijon kolektiviteti, rrjedhimisht kjo përkatësi e siguri e shtyn drejt imagjinimit historik e primordial të fisit si kërkesë imanente e njeriut për t'u çmuar, nderuar, njohur në vetvete dhe nga tjetri. Këtë kërkesë imanente njerëzore, si në rrafshin personal si në rrafshin kolektiv, grekët e vjetër e quanin *thymos*<sup>14</sup> apo thënë me terminologji me të re *dinjitet* personal e nacional. *Thymosi* është imagjinim mbi shenjat, por edhe imagjinim mbi të ardhmen. Pra, *Trungu dhe Koha*.

Ne do të zgjedhim disa vargje nga poezia *Trungu ilir* për të parë se si poeti imagjinojë të kaluarën, e cila i flet të tashmes.

*Rri i vërbuar nën Dhë në Mes-Dheun plak  
Pi ujin e zi të rrjedhës në qivur  
Kur shtrydh dorë e huaj a del gjak  
Nga zemra e fundosur gurëzuar në gur*

...

*Rri struktur rri dru nuk flet rri gur  
Në vitet e reja ndër shekujt e vonë*

...

*Pa shih o Zot si qajmë qeshim flasim njësoj  
Dhembjen klithjen vdekjen i mbjellim në tokë  
Kur dielli shkrumohet në det e në bokë  
E i skuq gjurmët në udhëtimin pluhurak  
Erren mendimet plas klithja në kokë  
Gjaku yt të ndjek në botë e në prak*

<sup>12</sup> Eric Hobsbawm, *The Invention of Tradition*, CUP, Cambridge, 1983.

<sup>13</sup> Shih: Anthony Smith, *National Identity*, Penguin Books, London, 1991.

<sup>14</sup> Plato, *Republic*, (Book II), Basic Books- Harper Collins, New York, 1991.

*Rri i vërbuar nën Dhe në Mes-Dheun plak  
Pi ujin e zi të rrjedhës në qivur  
Kur shtrydh dorë e huaj a del gjak  
Nga zemra e fundosur gurëzuar në gur<sup>15</sup>*

Imagjinimi mbi palcën etnike që rri “e vdekur” nën Dhe, si arkeologji identitare ilirike në Mes-Dheun Plak, imagjinimi mbi tendencën dhe intencën e tjetërsimit e harrimit, *gurëzuar në gur*, largimi nga rrënja si presion i kohës së re kosmopolitane, *degët lidhin kurorë si thikë si këmbonë* janë sferat e larta të diskutimit poetik me trungun ilir, i cili në vijimësi thërret për njohje si vetënjohje dhe mbrohet nga intenca identitare e poetit ngase *gjaku yt të ndjek në botë e në prak*, si kërkesë imanente e *thymosit*.

Ky libër arrin që simbolet identitare t’i shndërrojë në simbole universale!

Dominon vetëdija e autorit se identitarja është universalja dhe se Koha, me gjithë transformimet e saj, nuk duhet dhe nuk arrin të zhbëjë Trungun. Pra, dëshmohet filozofia e ekuilibrit klasik ndërmjet të vjetrës dhe të resë, një metafizikë e imagjinimit poetik identitar.

Poeti, në këtë libër krijon një mbretëri të simboleve, qofshin ato nga antikiteti etnik-shqiptar, qofshin nga koha moderne të objektivuara në varg. Përveç kësaj, pa lamentim e pompozitet, arrihet harmonizimi i simbolit poetik me emocionin e maturuar të subjektit lirik.

Raporti i poetit me *kohën* dhe *trungun* nuk është neo-folkloristik, evidencues e politik, por është syri i tij (poetit) që sheh imagjativisht botën “e vdekur” tek i flet botës së gjallë, fenomen ky që esencializon pikëpyetjen poetike, rrjedhimisht imagjinaretin metafizik identitar. Vargu i tillë buron nga religjioziteti artistik, nga intenca e imagjinimit, e cila vargun për traditën e nis drejt metafizikës, qoftë edhe kur vargu pikënisjen e ka në objektivimet reale arkeologjike, arki-gjuhësore e arki-historike.

Koncepti i *thymosit*, domosdo mbi kundrime të trajtave të ndërliqshme të kujdesit ndaj dinjitetit e veçantisë albane do të poetizohet edhe te veprat vijuese poetike *Leja e njohtimit 1985* (1985), *Kaosmos* (1990) e *ABC* (1994) ku intenca themelore e poetit është krijimi i ligjërimit që nisët nga situatat reale për të komunikuar me metafizikën.

*Leja e njohtimit 1985* ka për dominancë konceptet filozofike siç mund të jenë: vetvetja, identiteti, dinjiteti, njohja, rinjohja, tjetri etj., si problematizime të qenies poetike, qenie e cila duhet ta kapërcejë situatën ideologjike oruelliane, për ta synuar përjetësinë e poezisë si metafizikë personale e metafizikë nacionale, që të dyja të para si tharm i subjektit lirik. Kultu i individualitetit, i nacionit dhe i lirisë fitojnë shprehësi religjioze në varg me synim e ruajtjes së lakores evolutive si dinjitet për të ardhmen. Dinjiteti i së ardhmes mbrohet

<sup>15</sup> S. Hamiti, *Trungu ilir*, Rilindja, Prishtinë, 1979, ff. 14-15.

nëpërmjet kujtesës dhe reprezentimi i saj tek tjetri si veçanti personale e kolektive albane, rrjedhimisht duke mos përfunduar në *utopi*, e cila i humb referencat reale dhe si e tillë shndërrohet në *simulakrum*.

Mbi këtë filozofemë, librat poetikë *Kaosmos* dhe *ABC* reflektojnë poetikisht kërkesën e poetit për *rend* dhe *përkushtim*.

*Kaosmosi*, simbol i rikrijuar, kundër kaosit, por që forcon konceptet kosmologjike përbën rikthimin meditativ të poetit në vendlindje si ligjërim për vdekjet në varg si dhe reflektim mbi vdekjet në varg në nacion, të cilat e rrezikojnë qenien dhe ekzistencën. Libri kundër kaosit e kundër barbarisë, kundër sulmit ndaj trashëgimisë, një rikthim i përforcuar i luftës ndaj *harrimit* e kundër *natës* që jepet nëpërmjet refleksioneve të vargjeve të poezisë *Marshi barbar*:

*Nga terri vijnë në terr shkojmë  
Jeta jonë zgjatet sa zgjat nata<sup>16</sup>*

*Barbarët, terri, nata* – janë simbolet e *marshit* apo mizorisë, të cilat përshkojnë jetën nën barbarët apo terrin barbar ku ata *nuk janë pjesë e zgjidhjes* sikur te Konstandin Kavafi, por janë pjesë e tmerrit dhe terrorit mbi njerëzit si dhe mbi kulturën e lartë e dinjitetin njerëzor.

Në veprën *ABC* poeti krijohet në klasikën historike e kulturore, e cila na formon ne dhe imagjinon për palcën etnike shqiptare. *ABC* apo *Abetarja* shqiptare ka 36 poezi, të cilat në po aq dhembje figurojnë etninë, historinë, kulturën dhe paradokset tona, gjithnjë të kundruara nga prizmi i kultit për to, por të shtuara me vlerën e moralitetit e humanitetit.

Kur prizmi i poetit sforcon moralitetin kemi imagjinimin për figurat nacionale, ndërsa kur poeti sforcon humanitetin kemi paradokset e jetës në zgrip, siç sugjeron poezia *Jetimi* me vargjet:

*Fëmijët s'e luajnë më luftën po vdesin  
Nuk duan të ketë më jetima të jetimave<sup>17</sup>*

Këto vargje, në dukje me paradoksin si përmbysje, intencionalisht janë zbutur në abstragim, por janë forcuar në sugjerim, madje shënojnë një situatë konkrete ku më lufta nuk është vetëm kujtesë e keqe, e cila në pafajësinë e fëmijës duket lojë, por tashmë “loja” e tyre është vdekja e tyre. Këtu nuk ka heroizëm, por ka evidencë e thirrje për humanitetin. Prerja e vargut të jetimave të jetimave është thirrje latente, por e fortë e poetit: *O njeri!*, - e cila e veneruar dhe e provuar në realen shqiptare kap majat e universalitetit. Vlim i

<sup>16</sup> S. Hamiti, *Kaosmos*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 81.

<sup>17</sup> S. Hamiti, *ABC*, Rilindja, Prishtinë, 1994, f. 20.

jashtëzakonshëm ndjenjor, filozofik e metafizik ndodh në *psikenë* e poetit kur në honet e tij mendimtare qarkullon evidenca se fëmija ynë vdes, për më tepër vritet, e aq më tepër sakrifkohet!

Se poeti është genie në mërzë kjo nuk është maksimumi e re. Gjendja poetike, domosdo e mburjtur në kujtime, rikujtime e ndjeshmëri të lartë, fenomene këto që burojnë nga spiritualja e qenies e që maturohen në artin pa lament, shkakton përhershmërinë e mërzisë, por të asaj mërzitje që kthehet në forcë e që e përballon egërsinë e jetës dhe paradokset e moskuptimit.

Poeti ynë nuk e ka pasur “fatin” ta përjetojë vetëm mërzinë krijuese, e cila mbizotëron te qenia artistike qoftë edhe pa shkakësinë nga realja jetësore. Mërzia krijimtare e tij është përforcuar nga dehumaniteti i kohës së tij. Të refuzosh dehumanitetin, të mbrosh autentikën dhe të synosh lirinë njerëzore në kohë të mbizotërimit të dhunës, diktatit, bestialitetit e përplasjes së ideologjive do të thotë të bëhesh shenjë, madje shënjestër.

Poeti ynë, sado i vendosur në kohë e hapësirë, në hapësirën shqiptare dhe njëri nga veprimtarët themelorë për mbrojtjen e *albanizmit* nga tjetërsimi, me vizionin dhe fuqinë e të menduarit lucid dhe ngritjen e realiteteve të vrazhda në fenomene prapavështruese e paravështruese, qëndron përtej kohës së tij. Ky fakt e pengon kulturën e ulët, qoftë ajo me proviniençë të ashtuquajtur artistike, politike apo ideologjike. Poeti ynë përjeton mërzinë e tretë, moskuptimin!

Jo rrallë, historia na e thotë, se, autorët e *kanonit* tonë letrar e kulturor kanë përjetuar fatkeqësinë e moskuptimit, e cila ka çuar në mosnjohjen, mohimin e në raste ekstreme edhe vrasjen e tyre! Të mbrosh traditën, dinjitetin dhe identitetin nacional, qoftë edhe kur ky i fundit kurrë nuk ka treguar agresivitet gjatë historisë, do të thotë të jesh në shenjë, të jesh pakicë dhe i moskuptuar! E reja “pedante” të cilëson nostalgjik e neo-romantik, esencialist e anti-kosmopolit, rrjedhimisht në adeloshencën permanente teksa nuk pranon se vetënjohja është themel i mundësisë për ta njohur e për ta çmuar tjetrin!

Këto paradokse shqiptare figurohen te vepra e *metafizikës së melankolisë*, pra te vepra poetike *Melankolia* (1999) ku poeti, në variante, reflekton për qenien e vet, jep *topikat* e dhembjes, por duke mbrojtur gjithnjë *ëndërrimin*, si filozofi shpëtuese krijuese.

Në këtë udhë, *Melankolia* është libri i *trinisë poetike* më personale të Sabri Hamitit. Dihet se lirika e ka brenda vetvetes shpirtin autorial dhe se *trinia poetike* përbëhet nga *Dorëshkrimet*, si trajta të lidhjes së shkrimit me shpirtin, që imagjinojnë kohën, hapësirën e gjendjet e caktuara të subjektit poetik.

Në këtë *trini* hyjnë: *Dorëshkrimi i Prishtinës*, *Dorëshkrimi i Bluasë* dhe *Dorëshkrimi i Dumnicës*.

*Dorëshkrimi* (lidhja) me Prishtinën është figurë e *jetës së munguar*, *dorëshkrimi* me Bluanë është figura e *ringjalljes*, ndërsa *dorëshkrimi* i Dumnicës është figura e *gjenezës*.

Të gjitha këto *topika* shfaqin ndjeshëm *alter egon e autorit*, i cili kur lidhet me Prishtinën kujton vdekjet në vendin e vet dhe jetën e tij në teshun *me shkue a me mbetë*. Kur lidhet me Bluanë e Francës, kujton e dëshmon për plagët e trupit dhe të shpirtit dhe për forcën e ringjalljes, kurse, kur lidhet me kujtesën e tij, në refleksionet e vendlindjes, Dumnicën e Llapit në Kosovë, kujton shenjat themelore të jetës si ëndërrim të një bote që mbretëron si rikujtesë.

Kështu që, të tria këto gjendje shpirtërore shpërthejnë dhembje për ta bërë titullin e këtij libri tërësisht të motivuar, melankoli, por jo pikëllim, një vepër *elegjiake moderne*.

Elegjia nuk e relativizon autorin, madje e mban në fronin shekullor të krijimit dhe, sidomos në poezi, arrin që nga realja e ndodhia të imagjinojë për fatin apo fatkeqësinë e vet, duke hyrë kështu në zemër të lirikës apo të asaj që poeti (në fushën e studimeve) e quan *bioletër*.

*Elegjia moderne* këtu pëson ndryshim gjenerik, ngase nuk është *lament*, por *empiri poetike* me synim “dokumentimin” e përjetimeve e ndjesive të autorit.

Ta zëmë, te cikli *Dorëshkrimi i Bluasë* poeti rikujton dramacitetin e vrasjes së porositur ndaj tij, rikujtesë nga një gjendje shpirtërore, e cila dëshmohet me vargjet:

*Jam poet i vrarë i ndjekur nga egërsirat  
Me trupin një varr të shkrimtarit të huaj. –*

për të vijuar me vargjet e poezisë *Silueta me kasketë të Leninit*, nga e cila citojmë disa sosh:

*Në kohën kur terri nxin korridorin pa dritare  
Mes katit të parë e të dytë duke u ngjitur  
Më doli para silueta me kasketë të Leninit në kokë  
Shtiu silueta duke marrë në shenjë kokën e zemrën time  
Unë lëviza shpejt nga e djathta  
Plumbat zunë mushkërinë dhe dorën e majtë  
Silueta me kasketë të Leninit zbrazti edhe disa plumba  
Në shenjë triumfi e u humb në natë.<sup>18</sup>*

*Topika* e vrasjes, e cila për burimësi ka shkakun e refuzimit të një ideologjie rrafshuese nga poeti si dhe ngulmimin jetësor të poetit në mbrojtjen e *albanizmës*, pastaj *mimetika*, e cila zbret deri në përshkrim, e vrasjes, si dhe *Autori* në qendër të rikujtimit të vrasjes, bëjnë që poezia, qëllimshëm, të largohet nga fusha e abstragimit metaforik dhe të afrohet me fushën e *narracionit si dëshmi*. Ndërkaq, nga *narracioni poetik si dëshmi* të kapërcehet

<sup>18</sup> S. Hamiti, *Melankolia*, Faik Konica, Prishtinë, 1999, f. 39.

në metafizikë ku mbetet mister se si *trupi e zgjedh jetën*, gjithsesi simbas vullnetit hyjnor!

Poeti ynë, që nga vepra *Trungu ilir* e deri te *Melankolia*, por edhe te *Sympathia*, përveç ndijesimeve e imagjinimeve me burimësi *qenien* e tij, në poezinë e tij, përngjitur, imagjinoon për historinë e gjeografinë, qoftë ajo nacionale, qoftë si pikë reference e udhëtimit të tij real, por që realizohet si komunikim metafizik. Sepse, u tha, shumë shekuj më herët, se historia dhe gjeografia janë sytë e metafizikës. Mirëpo, poeti nuk e do historinë e gjeografinë si përshkrim, por lidhet me metafizikën për t'i kundruar ato mbi konceptin e religjiozitetit, humanitetit e dashurisë.

Mbi këtë konceptim realizohet edhe libri poetik *Sympathia* (2004), i cili forcon këto kategori duke u shkruar tashmë mbas një përvoje pelini e duke marrë peshën e testamentit. Meditacion themelor poetik në këtë vepër është *stuhia*, figurë që domosdo ndërliidhet me jetën e poetit, stuhi, e cila, në forma të ndërliqshme, e ka prekur qenien poetike në zgripctet *me shkue a me mbetë* duke e shtyrë drejt meditimeve filozofike për dhembjet personale, historike e nacionale etj. Nga *empiria* kapërcehet në poetikë, pra në poezinë si testament, e cila më së miri del në vargjet:

*Kam ndier ashtin e thyer në dorë*  
*Kam ndier mushkërinë e shpuar nën bri*  
*Kam ndier damarin e prerë në erë*  
*Dhe zemrën e plasur një herë përherë<sup>19</sup>*

*Zemra e plasur një herë përherë* është *stuhia* e jetës, por gjithnjë përbrenda saj qëndron *simpatia* (*Sympathia*) për humanitetin, si luftë e përherëshme e poetit për utilitaren, dashurinë e religjiozen, për dhuntinë metafizike të jetës, e cila duhet të çmohet e ruhet nga çdo *ideologemë*, sepse kjo e fundit rrezikon këtë dhunti të vetme të mbrujtur nga dashuria hyjnore.

Siç dihet, *ideologemat* apo *ideologjitë* nuk kanë të bëjnë me *humanen*, e aq më pak kur ato përdorën si mjet politik për *identitaren* që në fakt shkatërrojnë jetën e njeriut, memorien identitare në emër të një çlirimi utopist, i cili shqymë edhe jetën e fëmijës!

Dhe, ne, këtu, veçojmë vetëm një element, *stuhinë e luftës* dhe konceptimin e religjiozitetit, humanitetit dhe dashurisë së poetit, të shprehur në vargjet maksimë:

*Çliruesit janë bimë që i kanë shpëtuar stuhisë*  
*Rrënjët i njomin me gjak e lidhin molla të kuqe*  
*Të cilat i hanë fëmijët e tyre të lazduar<sup>20</sup>*

<sup>19</sup> S. Hamiti, *Sympathia – Testamente për Urtakun*, Faik Konica, Prishtinë, 2004, f. 31.

Po fëmijët e tjerë, fëmijët që nuk janë të çliruesve, fëmijët të cilët nuk i kanë shpëtuar *stuhisë*? Poeti e do jetën, jo krekosjen ideologjike, e cila e zbeh jetën në emër të idealit utopist se *rrënjët duhet të njomen me gjak për frytet e kuqe!* Poeti prapë, në formë latente, sikur thërret: O Njeri!

Testamenti i tij është Dashuria, që do të thotë Dhembja për njeriun, e cila duhet t'u mësohet fëmijëve të fëmijëve! Rebelimi i poetit ndodh pikërisht për faktin e mbrojtjes dhe të kujdesit ndaj Dashurisë si Universalitet.

Dashuria si dhembje është *kukutë* e përhershme, e cila e ka përcjellë poetin që nga *vdekja në rini* e nëpër të gjitha fazat e *pelinit jetësor* rrjedhimisht në *luftën* e tij për Njeriun e Dashurinë, si koncepte që duhet të mbrohen e shihen të mbrujtura me kult religjioziteti.

Në fakt, vepra *Kukuta e Sokratit* (2018) është Kukuta e Poetit, dhe Sokrati, si simbol, vetëm sa riaktualizon evidencën dhe mitin e përhershëm të Dijetarit, i cili vuan për Njeriun dhe e lutë Metafizikën për kujdes ndaj tij!

Arti, dija e shkenca vullnetin e njeriut e nisin drejt Metafizikës, ndërsa kjo e fundit, me shpresë, drejt vullnetit të Hyjit, apo siç do të lutej Lasgush Poradeci në poezinë e tij me vargjet:

*Që nga bota njerëzore, ku këndoj me shpirtin plot,  
Prit-e, prit! Se po t'afrohet Zog' i Qiejvet, o Zot!  
Fal-i Këngëtor-finoshit Gas të Thjeshtë mun në gji:  
Porsi lot në rreze djelli ndrit-e në Përjetësi!<sup>21</sup>*

Lasgush Poradeci që nga nisja e deri në fund, pra deri te Kukuta e tij, nga bota njerëzore “foli” me metafizikën si një zog i qiellit në udhën e tij të dritës e në Përjetësi.

Në këtë udhë edhe libri poetik *Kukuta e Sokratit* ridëshmon, në letrat shqipe, se s'ka poezi pa trashëgiminë sokratike të helmit dhe se poezia është vetëm dëshmi e fuqisë shpirtërore ku *autori e pi dhembjen e vet* për ta maturuar në vargun poetik si universalitet.

Mirëpo, te Kukuta e Sabri Hamitit, përveç dhembjes esenciale poetike, e cila mbretëron gjithnjë si meditacion metafizik që ndërlihet me problematizimet e qenies, jetës e ekzistencës së botës, pra si ontologji, vlerë esenciale mbetet dhembja për botën albane, një kukutë e përhershme e autorit, e cila ka marrë forma të larta artistike, të cilat të nisura nga rendi real e fenomenologjik shqiptar kanë arritur të realizohen në poezi metafizike me tipare universale.

<sup>20</sup> Ibid, f. 49.

<sup>21</sup> L. Poradeci, *Vepra I*, Tiranë, Onufri, 1999, f. 9.

Ky libër poetik ridëshmon se poeti lind dhe krijohet, dhe se nuk ka poezi të rinisë, as të pleqërisë, (edhe pse thamë se poeti nis të shkruajë në rini) por është poezi ajo shprehje gjuhësore, e cila arrin ta lartësojë pikëpyetjen filozofike për vetë ekzistencën tonë, pra, ajo kërkesë *aletheia*-ke, e cila në vazhdimësi jeton me ne dhe u rikthehet si pikëpyetje rrënjëve të saj metafizike.

Poeti, në këtë libër, çdo imagjinim e ndërlihdh me përjetimin e tij duke maturuar në të emocionin dhe mendimin për të krijuar *metafizikën poetike*, e cila në vargimet e saj ruan *zërin e parë* të poetit kur imagjinon subjektiven, *zërin e dytë* të poetit kur imagjinon për Njeriun dhe *zërin e tretë* të poetit kur situatat jetësore marrin trajta të ndërliqshme dramatike. Dhe këto tri tipe eliotiane të zërit të poetit hetohen fuqishëm te poezia *Hini* e sidomos te vargjet:

*Kur më shihni si grumbull hini  
Kujtoni sa i madh ishte zjarri*<sup>22</sup>

*Zëri i poetit* shëmbëllen me fushën e meditacionit metafizik ku nëpërmjet metaforave e simboleve arki-trashëgimore, qoftë me burimësi nga jeta apo nga literatura, ndërlihdh jetën (*zjarri*) me vdekjen (*hini*), por në mes tyre është një empiri, gnoseologji e imagjinim shpirtëror, një *psyche*, e cila në këtë ndërnmjetëz pi *mijëra kukuta* në udhën e idealitetit estetik nga *zjarri* deri te *hini*.

Dhe prapë rikthehemi të *kujtimi*, te mohimi *i harresës* dhe te vetëdija se Dashuria si universalitet është përbashkim i tokësore me hyjnoren, i individualitetit e identitetit, i estetikës si poetikë e si filozofi dhe se në komunikim me metafizikën gjithsesi relativizohet rrethi e vazhdon udha...

## VI. Udha

Jam jashtëzakonisht i vetëdijsëm se një tekst i tillë eseistik, interpretues e refleksiv, sikur çdo tekst i kësaj natyre, përpiqet të hetojë diçka, së paku si një refleksion personal, por nuk arrin më shumë se sa të jetë vetëm një indicie personale për Shenjën apo Botën e madhe të poetit të shprehur në dhjetë librat e deritashëm poetikë.

Mirëpo, jam gjithashtu i vetëdijsëm se, në kulturën e lartë letrare shqipe, ishin autorët Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci ata që, sipas koncepcioneve të tyre artistike, kultin e shkrimit të poezisë e panë si kult të komunikimit me metafizikën, rrjedhimisht si udhë drejt Providencës. *Differentia specifica* e poezisë së tyre e formoi *kanonin* tonë poetik, i cili na ruan e na formon në vijimësi për të na e mundësuar të themi: *unë jam unë* apo *ne jemi ne!*

<sup>22</sup> S. Hamiti, *Kukuta e Sokratit*, Albas, Tiranë, 2018, f. 7.

Në këtë udhë, jam i vetëdijshëm se mbas më shumë se një shekulli, Poezia e Sabri Hamitit, poezia e *autorit ontologjik* dhe *autorit Dichter modern*, i bashkohet këtij *kanoni* duke pritur lexime e interpretime të vazhdueshme...

Them, pa asnjë dyshim, sot e këtu, se vepra poetike e Sabri Hamitit, tashmë është një *trashëgimi nacionale*, një klasikë, një *përhershëmëri*. Fuqia e saj ka status të *imanencës albanologjike*.

Sabri Hamiti është emri i poetikës, autentikes e filozofisë si metafizikë, pa njohjen e së cilit, do të jemi më të varfër!

## BIBLIOGRAFI

Hamiti, S., *Njeriu vdes i ri*, Rilindja, Prishtinë, 1972.

Hamiti, S., *Faqe e fund*, Rilindja, Prishtinë, 1973.

Hamiti, S., *Thikë harrimi*, Rilindja, Prishtinë, 1975.

Hamiti, S., *Trungu ilir*, Rilindja, Prishtinë, 1979.

Hamiti, S., *Leja e njohtimit 1985*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

Hamiti, S., *Kaosmos*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

Hamiti, S., *ABC*, Rilindja, Prishtinë, 1994.

Hamiti, S., *Melankolia*, Faik Konica, Prishtinë, 1999.

Hamiti, S., *Sympathia*, Faik Konica, Prishtinë, 2004.

Hamiti, S., *Kukuta e Sokratit*, Albas, Tiranë, 2018.

\*\*\*

Bloom, H., *The Western Canon*, Harcourt Brace, New York, 1994.

Hamiti, S., *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003.

Heidegger, M., *Poetry, Language, Thought*, Harper Perennial, New York, 2001.

Hobsbawm, E., *The Invention of Tradition*, Cambridge University Press, Cambridge, 1983.

Krasniqi, N., *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, AIKD, Prishtinë, 2016.

Krasniqi, N., *Sabri Hamiti*, AIKD, Prishtinë, 2011.

Plato, *Republic*, (Book II), Basic Books - Harper Collins, New York, 1991.

Poradeci, L., *Vepra I*, Tiranë, Onufri, 1999.

Rugova, I., *Refuzimi estetik*, Rilindja, Prishtinë, 1987.

Rugova, I., *Strategjia e kuptimit*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

Scruton, R., *Modern Culture*, Bloomsbury, London, 2006.

Smith, A., *National Identity*, Penguin Books, London, 1991.

Vico, G., *The New Science*, Cornell University Press, New York, 1948.

**SUMMARY****METAPHYSICAL POETRY: REFLECTIONS ON THE POETRY  
OF SABRI HAMITI**

In this article we discussed the poetic Sabri Hamiti's work, tracking its evolution curve, with a focus on its metaphysical being. Also, as a preparation to interpret this type of poetry, we discussed the relationship between the poetry and metaphysics and the high culture, or poetry of imagination and realization thereof, in the Albanian poetic canon. Gradually, in detecting the concepts of poetic metaphysics, high culture, canon and its models in the tradition of the Albanian poetry, we reached the fundamental part, namely the reflections on Sabri Hamiti's metaphysical poetry. Reflections on Sabri Hamiti's poetry integrate the hermeneutic approach, where the analysis of the poetic verse i.e., the meaning thereof, becomes fundamental and does not intend to be a final or arbitrary denotation. We found that the phenomenon of poetic mystery is also motivated by the immanence of uniting author's emotion and thought with the mysteries of metaphysics, which emerge in the verses of his poems in complex forms. This is the power of a poetic systematics, of Sabri Hamiti's work, which is a monument of Albanian literary culture.